

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR 2 SAVRIKAL " SH.P.K.

Palet e poshteshenuar(ortaket):

- 1.-Dhimitër Niko Gjino
- 2.-Dhimiter Pilo Nino
- 3.-Thanas Vangjel Talo
- 4.-Mihallaq Andrea Ceko
- 5.-Kristo Pilo Nino

Kane hartuar kete statut per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar(Sh.P.K.),duke rene dakord midis tyre si me poshte:

Neni 1

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj private ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi,vecanerisht ne kuadrin e neneneve 11 dhe 12 te ligjit Nr.7491,date 29.04.1991"Per dispozitat kryesore Kushtetuese" dhe ligjit nr.7638 ,date 19.2.1993 "Per shoqerite tre getare".

Shoqeria funksionon sipas kontrates per krijimin e shoqerise dhe te statutit te saj.

Neni 2

Emri i shoqerise eshte " S A V R I K A L " Sh.P.K.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Vrion te Delvines.Shoqeria me vendim te Asamblese se ortakeve mund te trasferoje seline e vete ne nje qender tjeter banimi ose industrial dhe te krijojte filiale ne qytete te tjera brenda dhe jashte vendit.

Neni 4OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

- Nxjerrjen ,transportimin dhe shitjen e materialeve inerte,per qellme ndertimi ne objekte ndertimi dhe te infrastruktures,ose ne qendrat e perpunimit te materialeve inerte.
 - Germime dheu ose shkambi dhe transportimin e tyre ne objektet e ndertimit ose te infrastruktures.
 - Transport betoni te njome nga qendra e prodhimit te tij ose tete treteve dhe hedhja e tij ne objekte ndertimore.
 - Prodhim materialeve te ndertimit dhe shitja e tyre.
- Shitje dhe blerrje materiale ndertimore,makineri ndertimi makineri dhe pajisje bujqesore,automjete,mallra te konsumit te gjere,pjese kembimietj.,dhe eksport-import te mallrave te mesiperme.

Shoqeria objektin e veprimtarise se saj do ta zhvilloje ne rrethet Delvin dhe Sarande dhe poqe se ekzistojne kushte per veprimtarine e e saj,aktivitetin mund ta shtrijshe edhe ne rrethet e tjera.

Neni 5

Kohezgjatja dhe funksioni i shoqerise do te jete per 10 vjet,me te drejte anetareve ne marreveshje midis tyre ta zgjasin ose ta shkurtojne kohzgjatjen e funksionimit te shoqerise.Shoqeria e fillon veprimtarine e saj nga momenti i regjistrimit te saj ne gjykate.

Neni 6KAPITALI THEMELUES DHE PJESMARRJA NE KAPITAL

Kapitali themelues dhe pjesmarrja ne kapital si dhe kontributi i sejcilit ortak dhe ndryshimet e mundeshme,jane ato te percaktuara ne nenin 5 t okntrates se themelimit te shoqerise.

Neni 7

Neni 7TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferushem ndermjet paleve ne trashegimtaret dhe te afermit (pasardhes dhe parardhes). Transferimi i kapitalit ose i pjeseve te tij ne te treta behet pasi marrin dijeni ortaket dhe deklarojne se nuk kane interes per blerrjen e pjeseve qe transferohen.

Neni 8ORGANET E DREJTIMIT TE SHOQERISE DHE KOPETENCAT E TYREAsambleja e Ortakeve.

Eshte organi me i larte i shoqerise dhe perbehet nga te gjitha anetaret e shoqerise! Sejcili anetar ka vetem nje vote. Ai ka te drejte te marre pjese ne cdo mbledhje te asamblese, te diskutoje per cdo problem, te beje propozime dhe vrejttje perkatese dhe te votoje lirisht, pa u ndikuar nga te tjeret per problemet qe merren ne shqyrtim nga Asambleja dhe te kerkohet vendimi i saj.

Ne mungese te tij, sejcili ka te drejte te perfaqesohet ne mbledhje te Asamblese nga nje person tjeter i autorizuar prej tij. Ne autorizim percaktohet qarte koha e vlefshmerise se tij, plotesohet me shkrim dhe nga autorizuesi, ne dy kopje, ku njera arshivohet ne dokumentat e shoqerise. Asambleja e pergjitheshme e ortakeve, mblidhet si regull dy here ne vit, por mund te mblidhet edhe me shpesh.

Asamblene e theret:

-Kryetari i saj

-Me kerkesen e dy te tretat e anetareve te saj

-Me kerkesen e administratorit ose drejtorit te shoqerise

-Kryetari i komisionit te revizionimit.

Me te gjitha rastet lajmerimi behet me firmen e kryetarit te saj.

Asambleja ka keto kopetenca:



1. -Zgjedh keshillin drejtues, kryetarin e Asamblese, Drejtorin ose administratorin e shoqerise dhe komisionin e revizionimit.
2. Miraton kontraton dhe statutin e shoqerise dhe cdo ndryshim tetyre.
3. Miraton kontributin e sejcilit ortak ne kapitalin themelues dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerise te cdo anetari si dhe cdo ndryshim te tij.
4. Miraton programin e zhvillimit te shoqerise dhe te investimeve.
5. Miraton bilancin vjetor te shoqerise.
6. Vendos sa perqind te fitimit do te jepet anetareve per shlyerrjen kontributit te sejcilit anetar ne kapitalin e shoqerise, sa perqind do te shkoje si kontribut ne kapitalin e shoqerise dhe sa perqind do te ndahet anetareve si fitim neto i sejcilit!
7. Vendos pranimin e anetareve te rinje te shoqerise dhe te krijimit te shoqerive te perbashketa me subjekte te tjera.
8. Miraton blerjen e makinerive te renda sipas neneit 8 te kontrates themeluese.

Keshilli drejtues

- Perbehet nga tre anetare. Kryetari i keshillit drejtues eshte edhe kryetar i Asamblese se ortakeve.
- Keshilli drejtues eshte pergjegjes per realizimin e qellimeve te veprimtarise te shoqerise!
 - Miraton kontratat afatshkurtera dhe afatmesem te shoqerise me te tretet.
 - Vendos per tipin e makinerive dhe cmimin maksimal te blerrjes se tyre
 - Vendos per shitjen e makinerive qe nuk i sherbejne me shoqerise, pasi merret edhe mendimi i asamblese se ortakeve dhe per cmimin minimal te shitjes se tyre.

-Vendos per emerimin e personelit administrativ dhe te punonjesve te shoqerise.

-Vendos per rrogen e krytarit te keshillit drejtues, te drejtorit administrativ dhe te punonjeve e punetorev qe sherbejne ne shoqeri.

Keshilli drejtues si rregull mblidhet nje here ne muaj.

Drejtori administrativ ose administratori

-Eshte pergjegjes per realizimin e te gjitha detyrave operative te shoqerise, mban pergjegjesi per mireadministrimin e pasurise te shoqerise dhe te te gjitha vlerave monetare te saj.

-Kontrollon gjithe veprimtarine e punonjesve te saj.

-Eshte perfaqesues ligjor i shoqerise dhe perfaqeson ate ne te gjitha organet zyrtare shtetere, organe gjyqesore, brenda dhe jashte vendit si dhe ne marrredheneie me cdo person te jetur juridik e fizik vendas ose te huaj. Ne keto perfaqesime ai mund te autorizojte persona te tjere per probleme te vecanta te shoqerise.

-Ben propozime perkatese prane keshillit drejtues dhe ne asamblene e ortakeve per te marre vendime e duhura sipas kopetencave qe kane te pranuar ne kete statut.

-Kontraton per fronte pune me shoqeri ose investitore te trete. Ne ket rast ,mbi baze te preventivave, percakton vleren e te ardhurve qe do te realizohen nga punimet sipermarres. Per sa me siper ne mbledhjen me te afert te keshillit drejtues, ai jep informacion .

-Levizja e makinerive dhe forcave te punes behet vtem me urdher te drejtorit administrativ.

Komisioni i revizionimit.

Eshte organ kontrolli qe zgjidhet nga asambleja e ortakeve. Ai kontrollon gjithe veprimtarine nga ana financiare. Raportin e kontrollit e paraqet per analize ne asamblene e ortakeve. Me vendim te asamblese ky komision mund te zevendesohet me nje ekspert kontabel, i cili

kryen kontributet e komisionit te revizionimit.

Neni 9

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARRJA E FITIMIT

Çdo vit financiar fillon ne nje janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Viti i pare financiar i shoqerise fillon me regjistrimin e saj si person juridik.

Llogarite vjetore, investimet dhe raportet e vitit financiar dhe raportet te vecanta te hartuara nga drejtori administrativ, ose nga aparati kontabile te autorizuar miratohet nga asambleja me dy te tretat e votave.

Miratimi i dokumentit mbi veprimtarine financiare te shoqerise behet jo me vone se kater muaj mbas mbylljes se vitit financiar.

Fitimi vjetor qe rezulton nga te ardhurat qe sigurohen nga aktiviteti i shoqerise, duke zbritur:

- Shpenzimet e prodhimit (pjese kembimi, karburanti, goma, amortizimi i makinerive, shpenzime administrative, shpenzime per fuqi punetore e personeli etj.)

8 Detyrimet bankare.

^ thimi i kontributit vjetor i te sejcilit ortak.

- Detyrimet ndaj shtetit dhe te treteve.

Ai ndahet ne raport me perqindjen e kontributit qe sejcili ortak ka ne kapitalin e shoqerise, ne atae vit financiar. (sipas pikave b, c, d dhe e te nenit 5 te kontrates themeluese.

Neni 10

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 10 e (3) te kontrates themeluese, poqese ky afat nuk zgjatet me vendim te asa-

mblesë se ortakëve. Prishje të parakoheshme mund të bëhet vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve (mbi dy të tretat e ortakëve të votojnë pro), për arsye faktimi, ose për arsye të tjera ligjore.

Shoqëria nuk prishet kur të hiqet një ortak i saj.

Neni 11

LIKUJDIMI

Shoqëria hyjë në procesin e likuidimit të saj që në momentin e prishjes për kryerjen e këtij procesi, me vendim të asamblesë emërohet një likuidator, të cilit i paraqesin atij mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, për ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e kryerjes së tyre.

Në fund mbi bazën e raportit të asamblejës vendos mbi aktin përfundimtar të punës së likuidimit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Ndarrja e kapitalit të mbetur, pasi likuidohen të gjitha detyrimet që ka shoqëria, bëhet proporcionalisht me kapitalin që ka secili ortak në momentin që vendoset prishja e shoqërisë.

Neni 12

DISPOZITAT E FUNDIT

Shoqëria është e detyruar të japë përparësi ortakëve të shoqërisë ose familjes së tyre, në punësim. Kjo bëhet duke patur në konsideratë edhe aftësitë e tyre fizike e profesionale.

Asambleja e ortakëve merr vendime vetëm kur votojnë pro mbi dy të tretat e ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ky statut është hartuar sot me datën _____ në tërë kopje dhe firmoset si më poshtë nga palet formues të shoqërisë.